

Doracak Dhuna në familje gjatë krizës së Korona virusit (Covid-19)

Çdo person, madhor ose i mitur, viktimë e dhunës në familje, ka të drejta të cilat vlejnë edhe gjatë krizës së Korona virusit. Ky doracak identifikon ato të drejta dhe parashtron një varg mënyrash të vepruarit konkrete për t'u mbrojtur.

- 1. A jam viktimë e dhunës ?** Nëse pësoni fyerje, poshtërim, shantazh, goditje, keqtrajtime seksuale ose trysni financiare, **jeni viktimë e dhunës**. Nëse jeni "thjesht" të **rrezikuar** nga cënime të tilla, jeni po ashtu **viktimë**. Asnjë keqtrajtim nuk arsyetohet nga lidhjet afektive apo familjare; keni mundësi të mbroheni kundër veprimëve të burrit ose gruas suaj apo edhe partnerit, prindit ose fëmijës.
- 2. A ndryshojnë të drejtat e mia për shkak të masave sanitare të marra për shkak të Korona virusit ? Jo, situata e krijuar nga virusi Korona nuk ndryshon asgjë mbi të drejtat e viktimave të dhunës në familje.** Keni drejtë të kërkonti ndihmë dhe t'i kallzoni faktet.
- 3. A më lejohet të dal jashtë për të telefonuar dhe për të kërkuar ndihmë ? Po,** çdo person, madhor ose i mitur, viktimë e dhunës ose e kërcënuar/rrezikuar nga dhuna, mund t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për t'iu shmangur dhunës, duke përfshirë daljen në rrugë dhe kërkimin e ndihmës, madje edhe në (gjysmë) izolimi.
- 4. A janë të hapura stacionet policore gjatë krizës së virusit Korona ? Po,** aktualisht stacionet e policisë në **Pâquis dhe në Aeroport** janë të hapura 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Stacionet tjera janë të mbyllura për arsye sanitare. Ju gjithashtu mund të telefononi numrin **112** ose **117**.
- 5. Ku mund të gjej strehë? Foyer Le Pertuis ofron strehim urgjent** për të gjithë të rriturit që kanë nevojë për të (Route du Grand-Lancy 159, 1213 Onex). **Le Pertuis mbetet i hapur gjatë kohës së izolimit të pjesshëm dhe mund t'ju strehojë** (www.foj.ch/foyers/le-pertuis/; 022 309 57 28). Në rastet më të rënda të dhunës fizike dhe/apo psikike ose në raste të dhunës seksuale, ju gjithashtu mund të kontaktoni **Qendrën LAVI**, e cila do t'ju ndihmojë të organizoni qëndrimin tuaj në një shtëpi dhe do t'i mbulojë përkohësisht shpenzimet që lidhen me këtë akomodim, nëse është e nevojshme (022 320 01 02 ; nga e hëna deri të premten, nga 14h00 deri në 15h00, www.centrelavi-ge.ch ose me email në info@centrelavi-ge.ch).
- 6. Unë kam nevojë për trajtim mjekësor, çfarë të bëj ?** Mund të kontaktoni **Genève Médecins** në numrin **022 754 54 54**, ose të shkoni në **qendrën më të afërt mjekësore** (këto mbetën të hapura gjatë periudhës së izolimit të pjesshëm); identifikoni qendrën më të afërt duke kërkuar "permanence médicale" në www.google.com/maps , ose kontaktoni mjekun tuaj të familjes.
- 7. Nuk më lejojnë të dal nga nga banesa, kujt mund t'i telefonoj në rastë urgjence ?** Mund të kontaktoni **policinë** në numrin 112 ose 117 ose **linjën telefonike kantonale të dhunës në familje** në 0840 110 110.
- 8. Jam dëshmitar i një rasti të dhunës në familje, si mund të ndihmoj ?** Ju **vëzhgoni** ose **dëgjoni** një rast dhune në familje, mund t'i ofroni viktimës dëgjim dhe t'ia kaloni informatat e këti doracaku. Në raste urgjente, ju gjithashtu mund t'i telefononi policisë (112 ose 117) për të ndërhyrë.
- 9. Pranë kujt dhe si mund të parashtror një padi kundër agresorit-es tim-e ?** Në **stacionin policor** ose me postë në **Prokurori** (Ministère public), Route de Chancy 6B, 1213 Petit-Lancy, 1211 Genève (me ndihmën e Qendrës LAVI shiko pyetjen 5 më lartë ose të një avokati-e). Është e rëndësishme të kërkonti një raport mjeksor/proceverbal mjekësor të një sulmi seksual pranë një qendre mjeksore (shiko pyetjen 6 më lartë), njësisë së urgjencës gjinekologjike të HUG në 022 372 40 49, pranë UIMPV të HUG në 022 372 96 41 ose pranë ndonjë mjeku tjetër. Është gjithashtu thelbësore të ruani provat e dhunës (foto, foto të ekranit të telefonit me mesazhe, etj.). Keni poashtu mundësi ta raportoni autorin-en në polici në numrin 112 ose 117, ku do të regjistrohet një **procesverbal** i akteve të raportuara i cili mund të shërbej si provë.

- 10. Ç'farë do të ndodhë me agresorin-en tim-e dhe me mua nëse paraqes padi ?** **1.** Policia mbledh padinë tuaj dhe provat. Është e rëndësishme t'i jepni sa më shumë informata **2.** Policia merr në pyetje autorin-en dhe dëshmitarët e mundshëm. Ajo mund të shqiptojë masën mbrojtëse të largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira e banimit ose t'ju largojë juve për t'ju vendosur në vend të sigurt. **3.** Policia heton faktet dhe dërgon një raport në Prokurori (Prokurorit ose Prokurorës). **4.** Nëse elementet në dosje janë të mjaftueshëm, Prokurori-ja fillon hetimin dhe dëgjon përsëri palët (juve, autorin-en, dëshmitarët, etj.) gjatë një dëgjimi. **5.** Prokuroria mund të dënojë menjëherë autorin-en; në rastet më serioze, një gjykatë do të gjykojë autorin e dhunës.
- Gjatë gjithë procedurës keni të drejtë të shoqëroheni nga një person i besuar, i zgjedhur nga ju, të refuzoni të dëshmoni, të ndihmoheni nga një avokat-e dhe një përkthyes-e, të mos përbaleni me agresorin-en (dëgjim pas xhamave të errët që pamundësojnë pamjen) dhe të dëgjoheni nga një person i gjinisë së njëjtë
- 11. Pasi të paraqitet padia, a mund të ndryshoj mendje ?** **Po,** është e mundur të **pezulloni procedurën për 6 muaj** ose të **tërhiqni përfundimisht padinë** tuaj. Këto pyetje mund të trajtohen me Qendrën LAVI (shiko pyetjen 5 më lartë), një avokat-e ose një terapist-e.
- 12. A mund të ndahem nga bashkëshorti-ja/partneri-ja ime në çdo kohë ?** **Po,** për të mbrojtur veten dhe fëmijët tuaj nga dhuna e pësuar, ju mund të **kërkoni ndarje (masa mbrojtëse të lidhjes martesore) në çdo kohë dhe në mënyrë të njëanshme.** Gjykatat vazhdojnë të trajtojnë rastet urgjente. Gjykatësi-a më pas do të vendosë për masa të ndryshme si për shembull : kush qëndron në banesë, kush do të ketë kujdestarinë e fëmijëve, cila është e drejta për vizitë të fëmijëve, cili do të jetë kontributi për mirëmbajtje financiare. Nëse nuk jeni i/e martuar, vetëm çështjet e fëmijëve dhe ato financiare do të vendosen nga gjykatësi-ja. Është e rëndësishme që të grumbulloni sa më shumë dokumente për ta spjeguar gjendjen tuaj para gjykatësit (aspektët financiare, logjistike, të lidhura me fëmijët dhe të lidhura me keqtrajtimet ndër të tjera).
- 13. A është e mundur t'i ndalohe kryesit-es së dhunës të më afrohet, t'i afrohet vendbanimit dhe të na kontaktojë mua dhe të afërmit e mi ?** **Po,** policia mund të shqiptojë një **urdhër mbrojtje emergjente të largimit nga vendbanimi që zgjat 10 ditë** dhe t'i ndalojë agresorit-es t'ju kontaktojë juve apo të afërmit tuaj. Në kuadër të ndarjes ose në kuadër të një procedure të pavarur, gjykatësi-ja, sipas kërkesës, mund të shqiptojë masa të menjëherëshme (**masa parandaluese**). Këto masa do të përcaktojnë menjëherë se kush do të qëndrojë në vendbanim dhe do të parandalojë që autori-ja e dhunës t'ju afrohet dhe t'i afrohet vendbanimit, si dhe të kontaktojë me ju me çfarëdo mënyre (telefon, email, etj.). Në procedura të tilla këshillohet ndihma e një avokati-e.
- 14. A mund të largohem nga shtëpia me fëmijët e mi?** **Po,** detyra për të mbrojtur fëmijët ju lejon, në rrethana dhune në familje, të largoheni nga shtëpia juaj me fëmijët tuaj, megjithë autoritetin e mundshëm prindëror të përbashkët. Sidoqoftë është thelbësore të qëndroni në territorin zviceran dhe të njoftoni menjëherë **Shërbimin e Mbrojtjes së të Miturve (SPMi)** për largimin tuaj (022 546 10 00) dhe/ose të thërrisni një avokat-e, në mënyrë që hapat juridike të ndërmerren shpejt, që situata të jetë e rregulluar dhe të mos fajësoheni më pas.
- 15. A kam të drejtë të kem avokat-e, me kë mund të kontaktoj?** **Po, Qendra LAVI** (shiko pyetjen 5 më lartë) dhe **shoqatat e ndihmës së viktimave** (të listuara në fund të doracakut) mund t'ju japin detajet e kontaktit të një avokati të specializuar në dhunën në familje.
- 16. Kush do të paguajë tarifat e avokatëve dhe kostot e procedurave ?** Kostoja e procedurës dhe intervenimi i avokatës-it mund të mirren përsipër nga ndihma juridike falas, nëse gjendja juaj financiare nuk ju lejon t'i merrni ato kosto përsipër. **Për procedurën penale,** Qendra LAVI lëshon kupone për të mbuluar konsultimin e një avokati-e (shiko pyetjen 5).

**Subjektet e specializuara në ndihmë
të viktimave të dhunës në familje**

Numrat e urgjencës	
Policia : 112 ou 117	Urgjencë shëndetësore : 144
Genève Médecins : 022 754 54 54	Linja telefonike kantonale për dhunën në familje : 0840 110 110
Strehimi urgjent	
Le Pertuis Strehim urgjent për të rritur vetëm ose me fëmijë, i hapur 365 ditë në vit 24 orë në ditë edhe gjatë kohës së izolimit të pjeshëm. 159, route du Grand-Lancy, 1213 Onex, 022 879 62 14 et www.foj.ch/	
Mbështetje globale dhe konsultime psikologjike	
Ndihma për viktimat e dhunës në çift (AVVEC) Shoqata ofron konsultime për viktimat e dhunës në familje . Linja telefonike përgjigjet të hënën, të martën, të enjten dhe të premten nga ora 14h deri në ora 17h dhe të mërkurën e të premten nga ora 9h deri në ora 12h në 022 797 10 10. Test për të vlerësuar nëse jeni në situatë të dhunës në familje, intervista individuale, si dhe grupe diskutimesh - https://avvec.ch/fr ose me email info@avvec.ch	Dialogai Genève dhe Le Refuge Genève Shoqatat që i shërbejnë komunitetit LGBTQI + Shërbim i pandërprerë i ndihmës për viktimat e homofobisë dhe transfobisë së Shoqatës Dialogai i përgjigjet thirrjeve në çdo kohë në 076 382 55 84. Shërbim telefonik i pandërprerë i Refuge Genève përgjigjet ditëve të punës nga ora 12h deri në 20h në numrin 022 906 40 35, ose me email në accueil@refuge-genève.ch Zgjidhjet për strehim janë të mundshme
Pharos Genève Shërbim i ndihmës psikologjike, këshillimit social dhe i informacionit për burrat viktimat të dhunës në familje. 022 736 13 13 dhe www.pharos-geneve.ch/pharos/contact/	Njësia Ndërdisciplinore për Mjekësinë dhe Parandalimin e Dhunës (UIMPV) Psikiatrit, psikologët dhe infermierët e Spitalit Universitar të Gjenevës gjithashtu ju mirëpresin dhe mund të lëshojnë raporte mjekësore për gjendjen psikike të viktimave të dhunës. Boulevard de la Cluse 75, 1205 Genève. 022 372 96 41 nga e hëna në të premten nga 9h deri në 12h dhe nga 14h deri në 17h , shih po ashtu: www.hug-ge.ch/consultation/violence
Mbështetje ligjore dhe sociale	
Qendra LAVI Qendra e konsultimit për viktimat e veprave penale, të mbajtura gjatë kohës së izolimit të pjeshëm me telefon nga e hëna deri të premten prej orës 14h deri në 17h . Qendra mund t'ju drejtojë tek një avokat-e të specializuar në dhunën në familje dhe t'ju lëshojë një kupon për të siguruar që konsultimi i parë të jetë falas. 022 320 01 02 dhe http://centrelavi-ge.ch/	F-Information Hapësira e pritjes dhe orientimit për të mbështetur gratë dhe familjet në jetën e tyre të përditshme. I përgjigjen pyetjeve me telefon të hënave nga ora 14h deri në ora 17h, të martave dhe të enjteve nga ora 9h deri në orën 12h në numrin 022 740 31 10 ose me email në: femmes@f-information.org Ndihma juridike telefonike të enjteve nga ora 9h30 deri në orën 12h në 022 740 31 11 - www.f-information.org
Dhuna seksuale	
Viol Secours Shoqata u vjen në ndihmë grave, personave trans* dhe interseksuale nga 16 vjeç, viktimat të dhunës seksuale. Linja telefonike mirëmbahet të martave dhe të mërkurave nga ora 14h deri në orën 17h30 dhe të enjteve nga ora 9h30 deri në ora 13h . 022 345 2020, info@viol-secours.ch dhe www.viol-secours.ch/site2/index.html	Qendra e Këshillimit për Viktimat e Abuzimit Seksual (CTAS) Qendra terapeutike këshillon dhe udhëzon çdo person ose familje të prekur personalisht ose në mënyrë indirekte me temën e abuzimit seksual ndaj të miturve. Rue Jacques-Dalphin 36, 1227 Carouge 022 800 08 50, ctas@bluewin.ch dhe www.ctas.ch
Mbështetje për fëmijë dhe adoleshentë	
Shërbimi për mbrojtjen e të miturve (SPMI) Shërbimi kantonal përgjegjës për ndërhyrjen në interesin më të mirë të fëmijës në rast të keqtrajtimit. Linja telefonike përgjigjet nga e hëna deri të premten nga ora 8h deri në 12h30 në numrin 022 546 10 00. Boulevard Saint-Georges 16-18, 1205 Genève	
SOS Enfants Genève Linjë telefonike e psikologëve drejtuar fëmijëve dhe adoleshentëve. 022 312 11 12 ose www.sos-enfants.ch/index_for_mulairecontact.php	Pro Juventute Linjë telefonike për fëmijë dhe adoleshentë, konfidenciale dhe falas. 147 (telefon dhe SMS) 24h/24h 7d/7d ose conseils@147.ch
Ndihmë për autorët	
Face à Face Shoqata "Face à Face" mbështet gra, nëna dhe adoleshentë, vajza dhe djem të moshës 13-20 vjeç, të cilët janë agresivë dhe/ose të dhunshëm, si dhe familjet me marrëdhënie të dhunshme. 022 345 12 15, 078 811 91 17 ose ou www.face-a-face.info/	VIRES Konsultime për autorët e dhunës (të rritur). www.vires.ch/ , 022 328 44 33 dhe vires@bluewin.ch